

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**” two lines ” SHPK**

Sot, më datë 18/11/2023, u paraqit personalisht:

- **Z. Leonard Ceka**, i datëlindjes 20/01/1991, shtetas shqiptar, lindur ne Stojan dhe banues ne Lezhë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit meNr. 039108091 dhe Nr. Personal J10120103F.

e cila përpiloj këte akt themelimi të shoqërisë tregtare “two lines” SH.P.K, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**  
**Forma Ligjore**

Të themeloj Shoqërinë Tregtare "two lines" SH.P.K, në formën e një Shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria drejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri "two lines" SH.P.K, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe në Statut.

**NENI 2**  
**Qëllimi i krijimit të Shoqërisë.**

Qëllimi i krijimit të kësaj Shoqërie është zhvillimi i aktivitetit ekonomik në fusha të ndryshme tregtare. Veprimtaria e kësaj Shoqërie do të jetë tërësisht me karakter ekonomik dhe qëllim fitimprurës.

**NENI 3**  
**Emri dhe vula e shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin e subjektit "two lines" SH.P.K dhe me emrin tregtar **two lines**. Ajo do të ketë edhe vulën e saj.

**NENI 4**  
**Objekti i veprimitarise**

Objekt i aktivitetit te shoqerise do te jete cdo veprimtari e lejuar nga ligji dhe /ose pjesemarrje ne cdo aktivitet te ligjshem qe mund te kryeje nje shoqeri me persegjegesi te kufizuar, e krijuar ne baze te legjislacionit shqiptar, sic mund te ndryshohet here pas here dhe ne vecanti: Ndertimi i ndertesave rezidenciale dhe jo rezidenciale. Ndertimi I rrugeve dhe autostradave. Ndertimi i hekurudhave mbi dhe nen tokesore. Ndertimi i urave dhe tuneleve. Ndertimi I veprave te tubacioneve e kanalizimeve. Ndertimi i veprave te sherbimit komunal per energjine elektrike dhe telekomunikacione. Ndertimi i veprave ujore. Ndertimi I veprave te tjera te inxhinerise civile p.t.k.. Punime per prishje. Pergatitje e kantjerit te ndertimit. Instalime elektrike. Punime hidraulike, instalime te ngrohjes dhe kondicionimit te ajrit. Punime suvatimi. Punime montimi. Punime per veshjen e dyshemeve dhe mureve. Punime te tjera perfundimtare dhe finicioni te ndertesave. Punime te catise. Ujesjellesa, gazsjellesa, vepra kullimi e vaditje. Punime rifiniture druri, plastike, metalike dhe xhami, impiante te sinjalistikes ndricuese dhe jo ndriçuese te trafikut



rrugor. Te tjera punime te specializuara ndertimi. Punime topogeodezike. Aktivitete arkitekturore. Aktivitete inxhinjerike dhe konsulenca teknike te lidhura me to.

**NENI 5**  
**Selia e Shoqërisë dhe Afati**

Selia e Shoqërisë ndodhet në Lezhë, në adresën: **Lagjja Besëlidhja, Rr. Shtraus, Ndertesa, Njesi Kati 0, N.Pas. 5/118-N11, Z.K. 8632, Lezhë.**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një periudhe kohore pa afat.

**NENI 6**  
**Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar është Lekë 100.000 (njeqind mijë leke) dhe zotërohet nga ortaket themelues:

Vlera totale e kapitalit te regjistruar: Lekë 100.000 (njeqind mijë leke)

Vlera e paguar: 100.000 leke

Numri total i kuotave: 1.

**NENI 7**

Ortaket themeluese Shoqërisë Tregtare " **two lines** " SH.P.K zotërojne kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Ortaku themelues :	<b>Leonard Ceka</b>
Numri i kuotave :	<b>1</b>
Numri i pjeseve :	<b>1</b>
Pjesemarrja ne Shoqeri :	<b>100,00 %</b>
Lloji i kontributit:	<b>Ne para</b>
Vlera e kontributit	<b>100,000 ( njeqind mijë) leke</b>

Duke qene se Kapitali themeltar do te depozitohet ne llogarine e Shoqerise e cila do te hapet pas rregjistrimit ne QKB, atehere ortaku vendos qe kjo shume do te paguhet prej tij jo me vone 3 muaj nga data e regjistrimit te shoqerise ne QKB, ne llogarine e shoqerise tregtare.

Rregullat e pageses se kesaj shume jane parashikuar ne kete Statut.

**NENI 8**  
**Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", i ndryshuar, organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
2. Administratori/ët – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.



Faqe 2 nga 3

**NENI 9**  
**Administratori/ët**

Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit/ëve të cilët zgjidhen për një mandat 5 (pese) vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratori i shoqerise do te jete :

- **Z. Leonard Ceka**, i datëlindjes 20/01/1991, shtetas shqiptar, lindur ne Stojan dhe banues ne Lezhë, person madhor me zotësi të plotë për të vepruar, mbajtes i leternjoftimit meNr. 039108091 dhe Nr. Personal J10120103F.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administrator/ët, duke i ushtruar këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

**NENI 10**

Oratku/ Ortakët mund të vendosin me vullnetin e tyre, për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjeter privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

**NENI 11**

Ortaku/Ortakët detyrohen të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhëdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre.

**NENI 12**

Mosmarrveshjet për themelimin e Shoqërisë zgjidhen me mirekuptim dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata kompetente.

**NENI 13**

Akti i themelimit pasi u lexua nga Ortaku Themelues, u gjet sipas vullnit të tij dhe u nënshkrua pa vërejtje. Akti i Themelimit hartohet në gjuhën shqipe, duke qene se ortaku eshte njothes te gjuhes shqipe.

**ORTAKU THEMELUES**

Leonard Ceka

Leonard Ceka

